

FILLET DHE VEPRIMTARIA ARIVORE NË KOSOVË 1951 – 2008

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË – PROGRAMI ARKIVISTIKË

NGA

BEKIM MEHMETI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË – PROGRAMI ARKIVISTIKË

PRISHTINË

SHTATOR, 2022

FILLET DHE VEPRIMTARIA ARIVORE NË KOSOVË 1951 – 2008

Nga

BEKIM MEHMETI

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Vëmendje e veçantë i është kushtuar historikut të arkivit që nga themelimi i tij si institucion, lëndës arkivore, si bëhet pranimi dhe mbrojtja e saj, po ashtu edhe dokumenteve me karakter kulturor, duke dhënë informacione të përgjithshme mbi teoritë bashkëkohore të përcaktimit të këtij institucioni me një rëndësi të veçantë historike dhe kulturore të një populli.

Në Kosovë një zhvillim i tillë arkivor është i vonshëm , por kjo nuk do të thotë që arkivat e këtushme të mos përcjellin zhvillimet më të reja në fushën e krijimit, përpunimit dhe ruajtjes së dokumenteve në bartësit letër dhe digjital. Punimi shkencor që po paraqesim përfshihet në tre kapituj. Secili kapitull në vete zëbërthehet në nën tituj. Në kapitullin e parë paraqiten si pika të veçanta: Qëllimi, objektivat dhe metodologjia e kryerjes së punimit; Historiku dhe përkufizimet; Arkivat si institucione publike dhe menaxhimi i tyre; Baza ligjore e funksionimit dhe analiza krahasuese. Kapitulli i dytë përfshinë: Themelimi i Arkivit të Kosovës, Shërbimi arkivor i Kosovës, Fillimet e veprimtarisë arkivore prej 1951-2008; Mbi punën e këshillit arkivor, Arkivat ndërkomunalë të Kosovës; Ndryshimet në legjislacionin arkivor nëpër vite. Kapitulli i tretë paraqet: Konteksti institucional i menaxhimit të shërbimit arkivor; Organogrami;. Koncepte të përgjithshme mbi organizimin dhe menaxhimin e arkivave; Parimet dhe metodat e menaxhimit të shërbimit arkivor; Plani i klasifikimit të dokumenteve; Njohja dhe klasifikimi i dokumenteve; Klasifikimi i dokumenteve. Që nga shkrimi e këtej filluan të krijohen dokumente të ndryshme, ku trajtoheshin tema të larmishme dhe ku përmendeshin personalitete të ndryshëm. Nevoja për krijimin e arkivave u rrit, kështu krijimi i arkivave si institucione që për bazë kanë ruajtjen, përpunimin dhe restaurimin e dokumenteve, dolën në shesh edhe pengesat e hyrjes (aksesit) në dokumente, por jo për të gjitha këto, por vetëm për një numër të caktuar të tyre që ligji mbi arkivat i ndalon të

komunikohen brenda një afati të caktuar. Pengesat për hapjen e tërësishme të arkivave mbështeten në urdhëresat juridike dhe praktike. Nuk është e mjaftueshme, që për t'i bërë arkivat të hapura për publikun, të shënohet në preambulën e një kushtetute ose të një deklaratë të drejtave kryesore të lirisë së informimit të qytetarëve. Por, së pari duhet të sigurohen, nga njëra anë mjetet për ta zbatuar këtë të drejtë në tekstet ligjore në fuqi, dhe nga ana tjetër të informohen në mënyrë të drejtë qytetarët. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh se tendencat e përgjithshme, këtë dhjetë vjetshin e fundit mbështeten në shkurtimin e afateve të caktuara deri më tani. Historianët janë partizanë të këtij shkurtimi, por kjo dëshirë nuk është unanime. Shumë politikanë, diplomatë dhe funksionarë të lartë, mendojnë se shkurtimi i afateve rrezikon t'i bezdis ata në vazhdimin e çështjeve administrative. Ndërsa, në mesin e arkivistëve mbretëron frika se arkivat do të zbrazen nga përmbajtja e tyre, pasi që një dispozitë e tillë paraqet rrezik të shumëfishimit të asgjësimit të pakontrolluar, para arkivimit të dokumenteve nga persona dhe shërbime prodhuese. Prandaj, ligji mbi arkivat e Kosovës dhe të tjerët të ngjashëm janë ende mjetet më të mira të mbrojtjes së dokumenteve dhe për një kohë të gjatë kjo praktikë do të mbijetojë si më e mira.

Objektivi ynë ka qenë ilustrimi me shembuj mënyrën e zhvillimit dhe të avancimit të arkivistikës dhe punës arkivore në Kosovë si dhe fillet e veprimtarisë arkivore në Kosovë. Menaxhimi është proces i formësimit dhe mbajtjes në rrethin përkatës në të cilin janë individët, duke punuar së bashku në grupe realizojnë qëllimet e zgjedhura. Ky është në të vërtetë proces i realizimit të rezultateve të dëshiruara nëpërmjet veprimit të shfrytëzimit të resurseve njerëzore dhe materiale. Zhvillimi dhe reformat në botën arkivore, duke përfshirë edhe Kosovën, sugjerojnë se cikli historik që filloi në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë është afër përfundimit. Ndryshimet janë të thella. Dokumentet që kanë qenë, janë dhe do të mbeten treguesit kryesor të aktiviteteve të të gjitha poreve të jetës, meritojnë një tretman të veçantë në epokën në të cilën jemi duke jetuar, andaj shërbimi arkivor duhet të gëzojë një përkujdesje shumë më të madhe nga shoqëria dhe nga vet shteti. Punimi përfundon me konkluzione dhe rekomandime.